



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRZAVNA AGJENCIA ZA ZAŠTITU LICNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIA ARCHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Nr. Org. 01		Nr. Prot. 113	
Org. Jeshtr.		Prot. Nr.	
Org. Dant			
Nr. i faqeve 02		Data 27.08.2012	
Brez stranos		Date:	
No. pages:			
PRISHTINE/IA			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agjencia za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. prot./5/2012
Datë:27.08.2012

Në mbështetje të nenit 3,nenit 14,nenit 16,nenit 29 (paragrafi 1,2,nënparagrafi 2.1,2.3),nenit 35(paragrafi 1),nenit 48,nenit 69 i Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhëvane Personale,Mbikqyrësi Shtetëror nxjerr:

V E N D I M

1. Këshillohet Ministria e Forcës së Sigurisë që zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale brenda Ministrisë së Forcës së Sigurisë ta caktoj me vendim të veçantë.
2. Në regjistrin e hyrje dhe dalje nga ndërtesat e Ministrisë të shtohet edhe kolona (hapësira) për shënimin e adresës së përhershme ose të përkohshme,datën e hyrjes dhe dalje.
3. Hapësira e punës e sektorit të verifikimit të sigurisë të jetë më adekuate dhe e përshtatëshme për punë konform rëndësisë së dosjeve që duhet të ruhen në këtë sektor të rëndësishëm.
4. Obligohet Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës që në afatë prej 2 muaj të njoftoj Agjencinë për zbatimin e këshillave nga pika 1,2,3 e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Gjatë kontrollit që është bërë në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës kemi kostatuar që zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale i caktuar në MFSK,është caktuar vetëm me një njoftim elektronik.Neni 74 i Ligjit Nr.03/L-172 parasheh që të gjitha organet publike që përpunojnë të dhëna personale zgjedhin dhe caktojnë me shkrim një zyrtarë të brendshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Sipas nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-172 parasheh që organet e sektorit publik dhe privat për arsye të mbrojtjes së sigurisë së njerëzve dhe sigurimit të pronës mund të kërkojnë nga personat që hyjnë ose dalin nga ndërtesat tu japin të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni. Nëse konsiderohet e domosdoshme të dhënat personale mund të verifikohen duke i ekzaminuar dokumentet e identifikimit.

Të dhënat e regjistrimit të personave që hyjnë ose dalin nga ndërtesat mund të përmbajnë vetëm këto të dhëna personale: emrin (at) personal, numrin dhe llojin e dokumentit të identifikimit, adresën e përhershme ose të përkohshme, datën dhe kohën si dhe arsyen për hyrje në ndërtesë.

Të dhënat personale nga regjistrimet mund të ruhen deri në tri (3) vjet nga dita e regjistrimit të tyre dhe pastaj duhet të fshihen ose shkatërrohen, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

Neni 14 i Ligjit Nr.03/L-172 parasheh që sigurimi i të dhënave personale përfshinë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjiko-teknike për mbrojtjen e tyre dhe parandalimin e çfarëdo shkatërrimi të paqëllimshëm ose të qëllimshëm të paautorizuar, zbulimin, ndryshimin, qasjen ose përdorimin e të dhënave apo humbjen e papritur ose të qëllimshme të tyre, duke i mbrojtur lokalet, pajisjet dhe sistemet aplikative (softuerët), përfshirë edhe kontrollin e qasjes.

Sipas nenit 16 të Ligjit Nr.03/L-172 parashihet kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit e të dhënave duhet të kujdesen në çdo kohë që të dhënat personale janë të mbrojtura sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji.

Kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit e të dhënave duhet të përshkruajnë në aktet e tyre të brendshme procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale dhe duhet të emërojnë në formë të shkruar personat kompetent që janë përgjegjës për sistemin e dosjeve dhe personat të cilët, për shkak të natyrës së punës së tyre, duhet të përpunojnë të dhënat personale.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Ramadan



Vendimi i dërgohet:

- Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë